


PedaKos

Edukimi Parashkollor Aleanca për Zhvillimin e Kosovës

Raport shkencor i monitorimit

Janar 2022



HARTIMI I RAPORTITI U REALIZUA NGA:

Mevlude Aliu Gashi - Hulumtuese në Institutin Pedagogjik të Kosovës

ME MBËSHTETJE:

Valentina Gjinaj - RTM

Adriana Di Conca - RTM

Matteo Mancini - RTM

Cristian Fabbi - RCH

Elbasan Racaj - Përkthyes

PERSONAT E INTERVISTUAR (Drejtoreshat dhe Edukatorët e kopshteve):

Azemine Aliu, Bukurije Gashi, Danijela Markovic, Drita Rexhepi, Edi Puka, Fatime Demolli Mustafa, Fatmire Rugova, Indire Zenelaj, Jehona Cana, Lumnije Tahiri, Mentore Vokshi, Mejreme Rugova, Merita Halitaj Beqiri, Merita Rexhepi, Shpresa Hoxha, Sladjana Stanojkovic, Kimete Hoxha Jakupi, Mikete Hajdari, Leurita Valla, Engjeline Dukaj, Shkurte Bojniku, Blerta Noci, Laureta Hasanaj, Vlora Prenaj, Bernardete Palucaj Lekaj, Klodina Krasniqi, Mevlude Murtezi, Amanda Shkoza, Arbenita Basha, Kadrije Asllani.



Agjencioni për shërbime social-edukative
Agency for social-educative services
OIQ / NGO "SHPRESA E JETËS"



PedaKos

Preschool Education Development Alliance for Kosovo
AID011860

Ky raport u financua nga AICS-Agjenca Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AID011860). Pikëpamjet e shprehura në këtë produkt janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe politikat e AICS. AICS nuk mund të mbahet në asnjë mënyrë përgjegjëse për informacione të mundshme të pasakta dhe shpifëse ose për keqpërdorimin e tyre.

HYRJE

PEDAKOS-Edukimi Parashkollor Aleanca për Zhvillimin e Kosovës është një projekt tre vjeçar (2019/2022) i financuar nga Agjencia Italiane për Bashkërendim të Zhvillimit dhe i zbatuar nga OJQ Volontari del Mondo – RTM, me mbështetje të Ambasadës Italiane në Kosovë.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është mbështetja e institucioneve publike dhe palëve private të interesit në zbatimin e Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021, në kuadër të komponentit të fëmijërisë së hershme (0-5), kurse objektivi specifik është përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të arsimit (mosha 3-5) të cilat ofrohen nga kopshtet publike, private dhe me bazë në komunitet.

Rritja e cilësisë së shërbimeve në kuadër të arsimit parashkollor bazohet në tri shtylla:

- a) mbështetje ndaj kompetencave të stafit parashkollor përmes ofrimit të trajnimeve profesionale;
- b) nxitje, përmes shkëmbimit të praktikave të mira, e përqafimit të një qasjeje arsimore të bazuar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe potencialeve të fëmijëve, si dhe në ndarjen e përgjegjësisë në mes të palëve të sektorit;
- c) zbatim i partneritetit publiko-privat përmes reformimit dhe ringritjes së Kolegjiumit të Institucioneve Parashkollore.

Në këtë kuadër, PEDAKOS i referohet dhe e ofron Qasjen Reggio Emilia (QRE), së bashku me një sistem të ndërlidhur të arsimit dhe përvojave, duke pasur parasysh që këto praktika të mira njihen ndërkombëtarisht në fushën e arsimit të fëmijërisë së hershme.

Puna e PEDAKOS-it bazohet në një partneritet i cili përfshin, nga njëra anë, palët kryesore të cilat përfaqësojnë përvojat e Reggio Emilia-s si Komuna e Reggio Emilias – Institucioni i Kopshteve dhe i Çerdheve (IKÇ), Fondacioni E 35 (E35), si dhe Fondacioni Reggio Children (Qendra Ndërkombëtare Loris Malaguzzi (FRCH)), kurse nga ana tjetër përfshin Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Institutin Pedagogjik të Kosovës (IPK), Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës (FE-UP), si dhe tre ofrues të shërbime arsimore siç janë Kopshti Botanika, OJQ ChildProof dhe OJQ Shpresa e Jetës.

Sa i përket dy shtyllave të para të projektit, personelit të 15 kopshteve të Kosovës – të cilat e përfaqësojnë të gjithë territorin kombëtar si dhe të gjitha llojet e institucioneve parashkollore, përfshirë minoritetet etnike dhe fetare – iu është ofruar mundësi trajnimi (virtualisht dhe me prani fizike) lidhur me parimet, vlerat dhe praktikën e QRE-së. Në të njëjtën kohë, projekti u ka ofruar shkollave material mbështetës në mënyrë që t'ua mundësojë të njëjtave t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë në praktikë përmbajtjet dhe pikëpamjet teorike.

Kështu që, disa nga hapësirat e tyre (kopshteve) janë ri-rregulluar dhe janë pajisur me instrumente dhe materiale relevante për t'i zhvilluar aktivitetet e frymëzuara sipas QRE-së.

Në këtë kuadër, IPK-ja ka marrë pjesë në programin e trajnimeve dhe në aktivitetet e shkëmbimit të praktikave të mira, si dhe ka pasur rolin e monitorimit shkencor të projektit. Ky aktivitet ka nënkuptuar të raportuarit se si ndryshimet e promovuara nga projekti, në pikëpamje të qasjes pedagogjike dhe praktike, janë zbatuar nga 15 kopshtet pilot, me qëllim të vlerësimit të progresit dhe të zhvillimeve me kalimin e kohës.

Ky aktivitet monitorimi është zhvilluar për herë të parë në tremujorin e fundit të vitit 2021, për të vazhduar më pas në fund të vitit të dytë të zbatimit të projektit, që do të përsëritet përgjatë vitit të tretë, dhe në fundim të projektit. Ky dokument raporton mbi këtë hap të parë të monitorimit shkencor të procesit PEDAPOS dhe i njëjti përfshin gjetjet kryesore, përfundimet dhe rekomandimet.

Qasja Reggio Emilia

Qasja Reggio Emilia është një filozofi arsimore e bazuar në të imagjinuarit e fëmijës si qenie me potenciale të larta për zhvillim, si dhe të qenit një subjekt me të drejta të cilat nxënë përmes njëqind gjuhëve të cilat i përkasin të gjitha qenieve njerëzore dhe ku i njëjti rritet në marrëdhënie me të tjerët.

Kjo qasje bazohet në një seri shtyllash themelore:

- Punë kolegjiale dhe e bazuar në marrëdhënie për të gjithë punëtorët
- Prani ditore e një morie edukatoresh dhe mësuesish më fëmijët
- Atelieja dhe atelieristi
- Kuzhinat brenda shkollave
- Mjedisi si një edukator
- Dokumentim për të bërë të dukshëm procesin e të nxënies kreative
- Grupi i bashkërendimit të praktikave pedagogjike dhe arsimore
- Pjesëmarrja e familjeve

Fëmijët pajisen me potenciale të jashtëzakonshme për nxënie të cilat shndërrohen në një manifestim të një shkëmbimi të pa ndalur me kontekstin kulturor dhe atë shoqëror.

Çdo fëmijë është subjekt i së drejtës. Çdo fëmijë, individualisht apo në marrëdhënie me grupin, është ndërtues i përvojave të cilave ata iu japin kuptim dhe përmbajtje.

Fëmijët, si qenie njerëzore, janë në pronësi të njëqind gjuhëve: njëqind mënyra të të menduarit, shprehurit, kuptimit, si dhe takimit me tjetrin përmes të menduarit që na bashkon dhe nuk na ndan nga dimensionet e përvojave të

ndryshme. Njëqind gjuhët janë metaforë për potencialin e jashtëzakonshëm të fëmijëve, për ndërtimin e njohurive të tyre dhe të proceseve kreative, për format e pafundme përmes së cilave shfaqet jeta dhe ndërtohet njohuria.

Është përgjegjësi e qendrës për fëmijë, si dhe e institucionit parashkollor, t'i japë vlerë gjuhëve verbale dhe jo verbale përmes një dinjiteti të barabartë.

Çdo fëmijë, sikurse çdo qenie njerëzore, është ndërtues i njohurive, kompetencave dhe autonome.

Procesi i nxënies privilegjon strategjitë kërkimore, shkëmbimin dhe diskutimet, si dhe pjesëmarrjen me të tjerët.

Kërkimi përbën një dimension esencial të jetës së fëmijëve dhe të rriturve, një tension drejt njohurisë për t'u njohur dhe për t'u vlerësuar. Prioritet i jepet kërkimit në mes të rriturve dhe fëmijëve si një praktikë e përditshme, një sjellje e nevojshme për të interpretuar kompleksitetin e botës dhe një instrument i fuqishëm i ripërtëritjes së arsimimit.

Kërkimi, i shpërfaqur përmes dokumentimit, ndërton nxënien, riformulon njohurinë, është në themel të cilësive profesionale, kurse në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar shndërrohet në një element dhe garantues i inovacionit pedagogjik.

Dokumentimi është një pjesë integrale e teorive dhe praktikave të arsimimit dhe u jep atyre strukturë.

Kjo e bën të dukshme dhe të vlerësuar natyrën e procesit të arsimimit, është subjektive në grupe, tek fëmijët dhe të rriturit, si dhe i nxit ata drejt një trashëgimie të përbashkët.

Veprimi arsimor gdhendet përmes *projektimit/dizajnit* të didaktikës, mjedisit, pjesëmarrjes, ngritjes profesionale të personelit, dhe jo përmes aplikimit të programeve të paracaktuara.

Projektimi/dizajni realizohet përmes sinergjisë së ngushtë në mes të organizimit të punës dhe kërkimit arsimor.

Organizimi i punës, hapësirave, i kohës për fëmijë dhe të rritur, janë pjesë strukturore e vlerave dhe përzgjedhjeve të projektit të arsimimit.

Organizimi ndërton një rrjet të përgjegjësive të cilat ndahen me të tjerët në nivel të administratës, politikave dhe pedagogjisë. Kushtet e punës, si dhe format e kontratave, të cilat krijojnë stabilitet, vazhdueshmëri dhe ndjenjë të përkatësisë kanë një rendësi të veçantë.

Hapësirat e brendshme dhe të jashtme të qendrave për fëmijë dhe institucioneve parashkollore janë të dizajnuara dhe të organizuara në forma

të ndërlidhura. Të njëjtat iu ofrohen fëmijëve dhe të rriturve si hapësira për të qëndruar së bashku dhe për të bërë kërkime. Mjedisi ndërvepron, ndryshohet, dhe merr formë sipas marrëdhënies që krijohet me projekt dhe me përvojat e nxënies, në një dialog të vazhdueshëm në mes të arkitekturës dhe pedagogjisë.

Përkujdesja ndaj mobileve, objekteve, si dhe ndaj hapësirave ku zhvillohen aktivitetet përbën një akt arsimimi i cili prodhon mirëqenie psikologjike, prodhon një ndjenjë familjeje dhe përkatësie, një ndjesi estetike dhe një kënaqësi të qëndrimit. Po ashtu ka premisa primare dhe kushte mbi sigurinë në mjedise, një cilësi kjo e prodhuar nga dialogu dhe nga elaborimet e ndara në mes të profileve të ndryshme të profesionistëve të cilët merren dhe përkujdesen me këtë aspekt.

Ngritja/formimi profesional është një e drejtë dhe detyrë të secilit punëtor dhe e grupit, e përfshirë dhe e cilësuar si pjesë e orarit të punës dhe i organizuar brenda kolegjalitetit nga pikëpamja e përmbajtjes, formës dhe mënyrës së pjesëmarrjes së secilit pjesëmarrës.

Zhvillimi profesional zbatohet në sinergji në mes të takimeve 'për përditësim' të personelit në institucionet parashkollore dhe qendrat për fëmijë, planit për formim dhe ngritje profesionale në sistemin e shërbimeve arsimore të qytetit, si dhe mundësive arsimore dhe kulturore në qytet, në nivel kombëtar dhe atë ndërkombëtar.

Pjesëmarrja është një strategji e arsimit e cila ndërtohet dhe jetohej përgjatë takimeve dhe marrëdhënieve ditë pas dite. Pjesëmarrja i jep vlerë dhe i shfrytëzon njëqind gjuhët e fëmijëve dhe qenieve njerëzore, të cilat kuptohen si një pluralitet i pikëpamjeve dhe i kulturave.

Pjesëmarrja prodhon dhe i informon ndjenjat e kulturës së solidaritetit, përgjegjësisë dhe përfshirjes, si dhe prodhon ndryshime dhe kultura të reja.

Vlerësimi është një proces i cili i strukturon përvojat e arsimit dhe punën e shkollave dhe është pjesë e secilit aspekt të jetës së një shkolle, dhe si i tillë kuptohet si akt publik i dialogimit dhe interpretimit.

Me këtë objektiv në mendje, qendrat për fëmijë dhe institucionet parashkollore janë të pajisura me vegla – Karta e Shërbimeve, Këshillat e Qyteteve për Fëmijë, grupet e bashkërendimit pedagogjik, grupet kolektive të punës me shkolle si dhe prania e përbashkët dhe përgjegjësia e përbashkët dhe pronësia e përbashkët e punëtorëve – përfshirë praktikën si dokumentimi, pjesëmarrja e familjeve dhe komunitetit lokal, si dhe pjesëmarrja në sistemin publik të integruar të qytetit.

Metodologjia

Duke e pasur parasysh që Qasja Reggio Emilia është një filozofi arsimore, një mendësi, një sjellje kundrejt fëmijëve, të drejtave dhe kapaciteteve të tyre, atëherë nuk është e mundur që të njëjtën ta reduktojmë në kategori aktiviteteve për t'u zhvilluar nga edukatorët.

Në këtë kuptim, zhvillimi i instrumenteve të monitorimit për mbledhjen e të dhënave për të analizuar ndryshimet në kuptim të qasjes arsimore dhe praktikave, të promovuara nga projekti dhe të zbatuara nga shkollat, përqendrohet në identifikimin e një numri makro-dimensionesh për t'u vlerësuar. Instrumentet e monitorimit janë zhvilluar nga një hulumtues i IPK-së i cili e ka zbatuar të gjithë aktivitetin e monitorimit, me mbështetje të personelit të RTM-PEDAKOS, duke përfshirë edhe mbështetjen teknike të një pedagogu nga Reggio Children. Në vazhdim janë të paraqitura makro-dimensionet:

1. Përdorimi i brendshëm dhe i jashtëm i hapësirave;
2. Përdorimi i materialeve;
3. Planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve arsimore;
4. Bashkëpunim me familjet dhe përfshirje e komunitetit;
5. Zhvillim profesional i mësuesve.


Për secilën nga këto janë identifikuar disa nën-aspekte me qëllim që të sigurohemi se të gjitha veçoritë e secilit makro-dimension janë adresuar. Kjo vegël është përdorur për të zbatuar vëzhgimin dhe intervistat gjysmë të strukturuar të zhvilluara nga IPK-ja gjatë vizitave në 15 kopshte.

Vizitat në çdo kopsht kanë adresuar të gjithë rutinën ditore, duke filluar nga vëzhgimi i fillimit të aktiviteteve: arritja e fëmijëve në mëngjes, shërbimi i mëngjesit, zbatimi i aktiviteteve të planifikuara brenda dhe jashtë hapësirave, aktivitetet e lira, dreka dhe pjesa e mbetur. Pas kësaj, drejtoresha dhe një edukatore, të përfshira në PEDAKOS, janë intervistuar për t'u thelluar më tutje në aspektet e identifikuara.

Në hapin e mëtejshëm janë analizuar të dhënat, janë integruar të gjitha elementet e mbledhura nga secili kopsht, të cilat kanë rezultuar me gjetje dhe përfundime të paraqitura në këtë raport, duke ofruar po ashtu disa rekomandime.

GJETJET E MONITORIMIT

Ky raport përfshin të dhëna nga 15 pilot kopshte të përfshira në projektin PEDAKOS, të cilat janë trajnuar në parime, vlera dhe praktika të Qasjes Reggio Emilia, dhe të cilat janë pajisur me hapësira dhe materiale duke ua mundësuar zbatimin e aktiviteteve të frymëzuara nga kjo qasje.¹



¹ Derisa janë realizuar vizitat, në bazë të të cilave është përgatitur ky raport, 12 kopshte janë pajisur me pajisje duke i rinovuar hapësirat e tyre, në dy kopshte renovimet kanë qenë duke vazhduar, kurse në një kopsht renovimet ende nuk kishin filluar; të 15 kopshtet janë trajnuar si dhe kanë pranuar instrumente dhe materiale për t'i zbatuar aktivitetet e frymëzuara nga QRE

Të gjitha 15 kopshtet e synuara përfaqësojnë kategori, lloje kopshtesh dhe menaxhim të ndryshëm




Fig 1. . Llojet e kopshteve

1. Përdorimi i hapësirave (të brendshme dhe të jashtme)

Deri në momentin e kryerjes së vizitave nga të cilat është përgatitur raporti në fjalë, 12 kopshte ishin pajisur me hapësira të rinovuara, në 2 kopshte ishin duke u kryer punimet e rinovimit, ndërsa në një kopsht nuk kishin filluar ende punimet e rinovimit.

Në 14 kopshte, ambientet ku u realizuan aktivitetet me fëmijë ishin të ndritshme, të ngrohta dhe kanë se paku tri kënde ku fëmijët mund të eksplorojnë, ku janë të vendosura materiale për zhvillimin e fëmijëve në fusha të ndryshme.

Në shumë raste organizohen aktivitete në klasë apo në atele si, vizatim, ngjitje, modelim, punë me argjilë, prerje, ngjyrosje me ngjyra të ndryshme, lojë dramatike, lojëra lëvizore, këngë, etj. Ka pak raste kur përdoren hijet, dritat, tavolina me dritë, llupa, aparati fotografik, etj. Këto praktika janë më pak të njohura nga edukatorët dhe e paraqesin të nevojshme të marrin më shumë përvoja lidhur me të njëjtat përmes trajnimeve të radhës.

Në shumicën e kopshteve, ambienti është objekt komunikimi mes të rriturve dhe fëmijëve. Kjo shihet në angazhimin e stafit tjetër të kopshtit në mbështetje të mbarëvajtjes së punës me fëmijë, të drejtoreshës, të psikologes, edukatores mbështetëse, asistentes, kuzhinierëve, etj. Kjo shihet edhe në bashkëbisedimin edukatore-fëmijë, fëmijë- fëmijë, edhe në punimet e fëmijëve të vendosura në hapësira të ndryshme, në tabelat informuese për prindër, në pritje dhe përcjellje të fëmijëve, në të shprehurit e lirshëm të fëmijëve gjatë aktivitetit dhe në pranimin me lehtësi të vëzhgueses së jashtme në ambientet e tyre.

Në disa kopshte ambienti është i përshtatshëm, por nuk ka të rritur të tjerë që merren me grupin, përveç dy edukatoreve të grupit, ka komunikim fëmijë-fëmijë, por ka më pak komunikim fëmijë - edukatore. Në kohën e pranimit të

fëmijëve ka bashkëpunim me edukatorët e grupeve tjera dhe të fëmijëve të grupeve tjera, por më pak gjatë gjithë pjesës tjetër të ditës.

Në shumicën e kopshteve hapësirat e brendshme dhe të jashtme favorizojnë ndërveprim, eksplorim dhe kuriozitet për fëmijët, sepse është shfrytëzuar ambienti i brendshëm dhe i jashtëm, janë përdorur materiale të ndryshme dhe u është dhënë mundësi fëmijëve të flasin për materialet, t'i prekin, t'i shikojnë me llupë, të eksplorojnë përtej asaj që është përmendur gjatë bashkëbisedimit në takimin e përbashkët, etj.

Nga Projekti PEDAKOS, në përgjithësi deri në fund të vitit 2021, janë furnizuar me inventar dhe mjete 12 atelie. Të gjitha janë përshtatur hapësirave që ka pasur kopshti. Diku hapësira më të mëdha e diku më të vogla, janë furnizuar me inventar, materiale dhe mjete didaktike të nevojshme dhe shumë cilësore, diku është investuar në ambient të jashtëm, diku në trapezari, diku pritet të investohet pas renovimit komplet të kopshtit, etj.

Atelietë janë shumë mirë të furnizuara me materiale dhe mjete të nevojshme për punë me fëmijë por shfrytëzohen në mënyra të ndryshme. Në dy kopshte atelietë shfrytëzohet vetëm me gjysmën e grupit të fëmijëve me njëjërë edukatore dhe gjysma tjetër mbetet në klasë me edukatoren tjetër për arsye se atelietë kanë hapësira të vogla dhe kështu të njëjtat përdoren me rotacion . Pastaj, ka edhe raste kur ka shumë grupe që e shfrytëzojnë atelienë, por krijohet një orar për secilin grup.

Edukatoret e 15 kopshteve, në pjesën hyrëse të aktivitetit, realizojnë takimin e përbashkët me fëmijët, ku bashkëbisedojnë lidhur me temën që do ta trajtojnë gjatë ditës. Kjo praktikë u jep mundësinë fëmijëve të shprehen për gjërat që dinë dhe të japin ide të ndryshme për temat e caktuara. Kjo aplikohet në të gjitha kopshtet, diku me më shumë kompetencë profesionale të edukatores, e diku më pak, duke vënë në pah praktikën e cila tregon se edukatorët kanë filluar të zbatojnë filozofinë me fëmijën në qendër.

Sa i përket zhvillimit të fëmijëve përmes 100 gjuhëve të tyre, në kopshtet ku janë të organizuara mirë hapësirat dhe ku materialet shfrytëzohen si duhet, fëmijët kanë mundësi të shprehen në mënyra të ndryshme si: përmes vizatimit, modelimit, punës me argjilë, luajtjes së roleve, komunikimit verbal dhe jo verbal, etj. Dokumentimi i punës dhe të shprehurit e fëmijës dhe prezantimi para të tjerëve paraqet përdorimin e këtyre gjuhëve nga fëmijët dhe kjo ka filluar të praktikohet në disa raste.

Edukatoret e 13 kopshteve realizojnë aktivitete me fëmijë në grupe të vogla, në hapësira brenda klasës. Fëmijët në këto grupe, komunikojnë, bashkëveprojnë, ndërtojnë, zhvillojnë kompetencat individuale dhe kolektive,

sepse ata varësisht nga materialet që përdorin dhe mënyra e realizimit të aktivitetit, janë të angazhuar në punë grupore të ndryshme nga grupi në grup dhe me mundësi të ndërrimit të grupit pas një kohe. Në raste të rralla edhe pse në grupe të vogla fëmijët ndonjëherë udhëzohen nga edukatorja të bëjnë punën e njëjtë. Për punën në grupe të vogla jashtë klasës (në sheshe, në korridore, etj) ose edhe në mjedis të jashtëm, edukatorët kanë nevojë të marrin ende përvoja nga QRE, sepse këto janë praktikuar në pak raste.

Edukatoret kanë krijuar hapësira që fëmijët të kujdesen vet për veten e tyre, kur vijnë në kopsht, kur janë në aktivitet ku vet i marrin materialet e nevojshme, kalojnë vet nga një aktivitet në tjetrin, japin ide, tregojnë një ngjarje nga jeta e përditshme, pastrojnë tavolinat pas punës që bëjnë, vendosin gjërat në vendin e vet, janë të kujdesshëm në kuzhinë, në hapësirat tjera të kopshtit, etj.

Ka disa raste kur edukatorët deri diku u japin mundësi fëmijëve të shprehen në mënyra të ndryshme edhe pse fëmijët marrin vet materialet, por ata presin udhëzime të bëjnë atë që u thotë edukatorja. Po ashtu, presin kujdes nga prindërit kur vijnë për t'i marrë në kopsht, presin shërbim nga kuzhinierët gjatë ushqyerjes, nuk largojnë pjatat, etj. Ata vetorganizohen shumë mirë në oborr, kur kanë lojëra të lira, pa udhëzimet e edukatores. Ka ende raste kur në komunikimin mes fëmijëve pyetjet dhe përgjigjet janë të shkurtra me PO apo JO dhe pyetjet e edukatores i paraprijnë përgjigjes (sugjestive) jo eksploruese duke mos nxitur kërshtëri.

Në të gjitha shkollat punimet e fëmijëve vendosen në hapësira të dukshme për fëmijët dhe prindërit dhe disa nga këto punime vendosen në dosjet e fëmijëve. Ka raste kur punimet e fëmijëve u jepen fëmijëve me vete në shtëpi, kurse në njërin kopsht arsyeja pse fëmijët i marrin punimet në shtëpi ndërlidhet me sensibilizimin e komunitetit për rëndësinë e edukimit parashkollor.

Gjatë vëzhgimit disa kopshte shfrytëzuan ambientin e jashtëm për të realizuar aktivitetet me fëmijë, ndërsa në më shumë nga ato aktivitetet u realizuan në ambiente të brendshme, edhe pse ambienti i jashtëm ka kushte të mira për fëmijët. Projekti PEDAPOS rregulloi disa hapësira e jashtme shumë funksionale për fëmijët, por ato nuk u shfrytëzuan nga edukatorët dhe fëmijët dhe gjatë intervistës edukatorët theksuan se hapësirat shfrytëzohen nga të gjithë fëmijët e kopshtit, por që në ditën e vëzhgimit plani i punës së tyre ishte për aktivitete brenda kopshtit.

Në shumicën e kopshteve (12 kopshte) kuzhina shfrytëzohet, përveç për t'u ushqyer, edhe si hapësirë edukative, ku bashkëvepron stafi me fëmijët, duke shfrytëzuar kuzhinën për të përgatitur ushqime si biskota, tortë, sallata të ndryshme të stinëve, lëngje nga frutat etj, në lidhje me tema të ndryshme.

Në tri kopshte kuzhina shfrytëzohet nga fëmijët për t'u ushqyer dhe për të marrë dhe kthyer pjatat në karrocet përmes së cilave vjen ushqimi në trapezari, por edhe të tilla që fëmijët i shfrytëzojnë ato hapësira vetëm për të marrë ushqimin.

2. Përdorimi i materialeve

Në disa kopshte materialet janë mirë të prezantuara, duke u dhënë mundësinë fëmijëve t'i prekin ato, t'i vëzhgojnë, të flasin për të njëjtat dhe pastaj të kalojnë në përdorimin e tyre.

Ndërsa në kopshte tjera janë shpërndarë materialet dhe ka filluar menjëherë puna në realizim të aktivitetit, e në përfundim pastaj kanë filluar të flasin se çfarë janë, për çfarë na duhen apo kur kanë qenë pemë ose perime njëherë janë vizatuar pastaj janë shijuar. Nuk është vëzhguar materiali para realizimit të aktivitetit por pas realizimit. Ka raste kur materialet janë vendosur në ndërlidhje me temën dhe sipas udhëzimeve fëmijët kanë vazhduar punën.

Të 15 kopshtet kanë marrë trajnime përkatëse, instrumente dhe materiale për të zbatuar aktivitete të frymëzuara nga Qasja Reggio Emilia.

Në ato kopshte (11 kopshte), ku u prezantuan mirë materialet, fëmijët filluan të flasin për ato, të marrin edhe mjete të tjera për të vëzhguar apo hulumtuar materialin si. llupët apo tavolinën dritë-hije, etj, duke bashkëbiseduar rreth materialeve, rreth ndryshimeve, tek pemët i shijojnë pemët, flasin për shijet, etj, dhe pastaj vazhdojnë me vizatim, modelim, përgatitje të lëngjeve me pemë, etj., varësisht nga ajo se me çfarë kishte të bënte aktiviteti i planifikuar.

Në kopshtet tjera, ku nuk u prezantuan si duhet materialet, u realizuan aktivitetet e vizatimit, modelimit etj, por gjithnjë me edukatoren në mbikëqyrje se ku të vendosin diçka, si të bëjnë atë, përmes udhëzimeve të qarta në mënyrë që punimi të duket bukur.

Në katër kopshte përdoren edhe librat (aty ku janë fëmijët e moshës 5-6vjeç) dhe të gjithë fëmijët bëjnë të njëjtën gjë, të gjithë shkruajnë, të gjithë ngjyrosin, sipas modelit në libër. Kjo i kufizon fëmijët në përdorim të materialeve tjera dhe punimet janë pothuajse të njëjta.

Fëmijët janë kompetent aq sa të rriturit iu japin mundësi (edukatorët, prindërit, komuniteti, të gjithë të rriturit e tjerë), prandaj për të krijuar një imazh të fëmijës si qytetar i sotëm, jo si qytetar i ardhshëm, në kopshtet tona ka nevojë ende për përmirësim.

Në të gjitha kopshtet (15 kopshte) kishte materiale didaktike të mjaftueshme (letër, ngjyra, markerë, brusha, argjila, ngjitës, gërsërë, etj), kishte më pak mjete didaktike (llupë, aparat fotografik, mikroskop, kompjuter, etj). Në më

shumë kopshte 15 kopshte kishte materiale të natyrës (gjethe, drurë, bari, gështenja, arra). Nga 15 kopshtet përfituese 1420 fëmijë përdorin dhe kane qasje ne materiale ricikluese.

Ne të gjitha kopshtet materialet janë në përputhje me aktivitetin dhe në disa kopshte ato u përdoren, u pasuruan me materiale shtesë, disa u plotësuan me materiale që dolën t'i marrin në natyrë, përfshirë edhe kombinimin e tyre. Ndërsa në disa raste materialet janë në përputhje me aktivitetin, por janë paksa kufizuese për përdorim, p.sh. letra të fotokopjuara ku fëmijët duhet të punojnë në ato, brenda vijave dhe hapësirave të gatshme, jo të krijuara nga vet fëmijët.

3. Planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve edukative

Në këto kopshte, 15 grupet e fëmijëve të përfshirë në aktivitete të frymëzuara nga QRE janë të moshave 3 deri ne 6 vjeç për një total prej 257 fëmijë



Fig 2. Grupet e fëmijëve sipas moshës

Sa i përket edukatoreve që punojnë me fëmijët 3-4 vjeç dhe 4-5vjeç, takimet përgatitore për planin e punës edukative bëhen ndryshe nga kopshti në kopsht, vetëm planin vjetor të gjitha e bëjnë në të njëjtën kohë, pra në përfundim të vitit shkollor përgatitet plani vjetor për vitin e ardhshëm shkollor. Aty mblidhen të gjitha edukatorët, vendosen temat dymujore ose mujore. Pastaj, për secilin grup dy edukatorët e grupit (në tri raste ka vetëm nga një edukatore në grup), mblidhen dhe e zbërthejnë planin, bazuar në treguesit e Standardeve të Zhvillimit dhe të Mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-6vjeç.

Në kopshte ku edukatorët punojnë me fëmijët e moshës 5-6vjet, plani zërthehet nga plani lëndor dhe Kurrikula bërthamë për klasën parafillore, të cilat janë dokument zyrtar nga MASHTI. Planit dymujor përgatitet nga aktiviteti i edukatorëve të komunës për të gjitha edukatorët parafillore (në kopshte, shkolla, qendra me bazë në komunitet, etj.) dhe të njëjtin plan ato kanë mundësi të përshtatin për fëmijët e grupit vetëm aktivitetet ditore.

Ndërsa për fëmijët e moshës 3-4 vjeç dhe 4-5vjeç përshtatet plani vjetor dhe bëhet i përbashkët me edukatorët e tjera të kopshtit, ndërsa plani javor dhe ditë përshtatet për moshën dhe arrijtjet e fëmijëve të grupit.

Në një kopsht organizohen pesë takime të obligueshme në vit, me të gjitha edukatorët e kopshtit, për të biseduar për mbarëvajtjen e realizimit të planit apo për ndryshime eventuale. Në një kopsht tjetër, kanë tri takime të obligueshme.

Vetëm disa nga kopshtet edukatorët e grupit kanë takime ditore (në përfundim të orarit), me praninë, në shumë raste, edhe drejtoreshës, për të biseduar për ditën që vjen, çfarë të ndryshohet në plan, cilat materiale duhen, a ka nevojë që bazuar në interesat e fëmijëve të ndryshohet plani, apo të shtohen materiale të tjera, etj.

Edukatorët dhe drejtoreshat paraqesin përvoja se si kanë bashkëpunuar me familjen para pandemisë, por me situatën pandemike nuk kanë planifikuar aktivitete ku mund të përfshihen edhe prindërit, sepse masat e Qeverisë së Kosovës kanë ndaluar që në hapësirat e brendshme të kopshteve dhe shkollave të kenë qasje prindërit dhe të rritur të tjerë përveç fëmijëve dhe stafit.

Kanë paraqitur përvoja se si më parë kanë vendosur në plan mundësinë e përfshirjes së familjes dhe komunitetit, por me situatën pandemike nuk kanë planifikuar aktivitete ku mund të përfshihen edhe prindërit, sepse masat e Qeverisë së Kosovës kanë ndaluar që në hapësirat e brendshme të kopshteve dhe shkollave të kenë qasje prindërit dhe të rritur të tjerë përveç fëmijëve dhe stafit.

Drejtoreshat në 15 kopshte potencuan se planet vjetore u prezantohen prindërve në fillim të vitit shkollor. Deri në vitin e fundit kanë mbajtur nga tri takime të obligueshme me prind, ndërsa këtë vit, duke respektuar masat pandemike, planet vjetore i janë dërguar online prindërve dhe kanë mbajtur takime online ku kanë kërkuar që të sugjerojnë, plotësojnë apo të japin ndonjë ide edhe pse, zakonisht, prindërit pajtohen me planin dhe janë të gatshëm të kontribuojnë në realizim, nëse nga kopshti u kërkohet mbështetje. Në një kopsht, prindërit në takim kanë kërkuar që me fëmijët e moshës 5-6vjeç të mos përdoret pako me tekste. Kjo është respektuar dhe të njëjtat nuk

përdoren. Në disa raste, planet mujore dhe javore vendosen në tabelën e informatave për prindër dhe prindërit janë të njoftuar se çka do të realizohet në aktivitete me fëmijët e tyre, ndonjëherë ofrojnë mbështetje.

Në 15 kopshte drejtoreshat kanë filluar të vëzhgojnë edukatorët për mënyrat e realizimit të aktiviteteve. Edukatorët mbështetëse dhe asistentët (në ato kopshte ku janë ato) mbështesin fëmijët me nevoja të veçanta dhe i bëjnë pjesë të aktiviteteve të përbashkëta, por edhe planifikimi i punës dhe qasja e edukatores dhe e gjithë stafit ndaj fëmijës, ka filluar të ketë ndryshime për të mirë.

Në disa grupe (tetë grupe) ku u realizua monitorimi, nuk ka fare fëmijë me nevoja të veçanta, ndërsa në grupet (shtatë grupe) ku ka fëmijë me nevoja të veçanta, ka mbështetje nga psikologë të kopshtit, edukatore mbështetëse ose asistente. Po ashtu, në tri nga 15 kopshte edhe drejtoreshat janë me profesion psikologe.

Në dy nga 15 kopshte ka bashkëpunim me shoqata jashtë kopshtit për fëmijët me të drejta të veçanta ku konsultohen me profesionist dhe përkrahen edhe prindërit, por në raste të tjera prindërit privatisht trajtojnë fëmijët tek profesionistë të ndryshëm dhe në kopsht sjellin vetëm rekomandimet e tyre se si të punojnë në kopsht me atë fëmijë. Në disa kopshte potencuan se është funksionale ekipi i komunës për vlerësim të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe u ndihmojnë edukatoreve në hartimin e planit individual.

Lidhur me vëzhgimin, 15 kopshte kanë realizuar një pjesë elementare të vëzhgimit që deri me tani ishte një praktikë në kopshte, ku përmes një listë kontrolli të bazuar në tregues të arritjeve të fëmijëve dhe e ndarë nëpër fusha të zhvillimit të fëmijës (fushat e SZHMFH 0-6 ose të Kurrikulës Bërthamë për klasën përgatitore), edukatorët kanë realizuar vëzhgimin.

Nga përvojat që janë marrë në QRE, vetëm dy kopshte kanë përdorur praktika të tilla. Gjatë intervistave edukatorët theksuan se nuk e kanë kuptuar sa duhet procesin e vëzhgimit, prandaj nuk dinë si ta realizojnë atë.

Edukatorët e 15 kopshteve praktikojnë dokumentimin në forma të ndryshme, me fotografi nga aktivitetet e fëmijëve, me video, duke vendosur punime e fëmijëve në vende të dukshme. Kanë krijuar dosjet e fëmijëve ku vendosen punimet e fëmijëve dhe kohë pas kohe fëmijët i marrin ato dosje në shtëpi.

Sa i përket dokumentimit, sikurse është ofruar në trajnim REA, vetëm në dy kopshte është realizuar dokumentimi, janë mbajtur shënime gjatë aktivitetit dhe janë shprehur se edukatorët mblidhen dhe planifikojnë për ditët në vazhdim bazuar në dokumentim

Edukatorët e grupeve tjera të 13 kopshteve gjatë intervistave u shprehen se

kanë fleksibilitet kur për momentin rastis që fëmijët të mos kenë interesim për një temë, e ndryshojnë aty për aty rrjedhën e aktivitetit ditor, por jo si diçka që bazohet në vëzhgim të mëparshëm.

Projekt mirëfilli, sikur kemi parë përvojat në trajnimet me projektin PEDAKOS, të 15 kopshtet kanë bërë vetëm gjatë trajnimeve si: projekte edukative (biçikleta, letra, ushqimet tradicionale, çaji, etj). Nuk ka projekte të tjera në realizim. Vetëm një kopsht ka planifikuar që të realizojë një projekt me titullin „LIBRI”, i planifikuar për muajin prill. Gjatë intervistave u theksua se do të bëjnë përpjekje që temat mujore që i kanë në planin e tyre, t'i realizojnë sipas hapave që kanë mësuar në trajnim. Pra, projekte që kanë të bëjë me kërkimin, eksplorimin, vizitat, punimet e gjithçka të përcjella me vëzhgim dhe dokumentim.

4. Bashkëpunimi me familjen dhe përfshirja e komunitetit

Në kopshtet që janë qendra me bazë në komunitet (dy kopshte), këshilli i prindërve dhe drejtoresha e menaxhojnë kopshtin. Këshilli i prindërve mbanë takime me prindërit e secilës klasë, me ose pa prezencën e edukatores, por me prezencën e drejtoreshës (tani takime online).

Në kopshte tjera (13 kopshte) theksuan se lirimi i masave pandemike u lejon deri në 30 persona në takime me pjesëmarrje fizike dhe kanë filluar të mbajnë takime me prindër si dhe të bëjnë vizita me fëmijë. Megjithatë, ka edhe kopshte që nuk kanë realizuar takime me prindër, për arsye të situatës pandemike.

Një kopsht ka realizuar në oborr të tij aktivitete ku kanë punuar prindërit bashkë me fëmijët e tyre. Ky aktivitet u realizua për të vetëdijesuar komunitetin që t'i sjellin fëmijët në kopsht (qendër shumë etnike).

Në katër kopshte të tjera, me lirimin e masave pandemike, kanë filluar të realizohen aktivitete me prindër dhe njëri kopsht me përkrahjen e prindërve ka realizuar një vizitë me fëmijët në aeroport.

Ka kopshte që për arsye të pandemisë nuk kanë realizuar aktivitete me prindër, por të 15 kopshtet kanë dëshmi e foto që para pandemisë kanë pasur bashkëpunim të mirë me prindërit.

Në disa kopshte prindërit janë të gatshëm të përkrahin me materiale, sipas nevojës. Në njërin kopsht prindërit kanë krijuar një kënd të librave dhe kanë sjellë libra për fëmijë, në dy kopshte tjera kanë krijuar këndin e vjeshtës, me pemë e perime të vjeshtës, të sjella të gjitha nga prindërit. Ka raste që kanë krijuar fondin e prindërve, që menaxhohet nga prindërit dhe me atë buxhet mbulohen shpenzimet për materiale, apo për ndonjë vizitë të fëmijëve. Ka

edhe raste kur ata shprehen se paguajnë për kopshtin dhe nuk u intereson më tutje.

Informimi i prindërve, për aktivitetet që realizohen në kopsht me fëmijët e tyre, bëhet gjatë pranimit-përcjelljes së fëmijës dhe përmes grupeve të mbyllura online (Facebook, Viber,), përmes e-mailit, etj.

Në disa kopshte kanë organizuar ndonjë takim me komunitetin në ambient të jashtëm, pavarësisht se ishte situatë pandemike. Në njërin kopsht kryetari i fshatit ka organizuar të gjithë fshatarët të sjellin pemë dhe perime, që kanë vjelë në kopshtet e tyre dhe i kanë sjellë për t'i bërë ushqim për fëmijët e kopshtit. Ndërsa në kopshtin tjetër kanë realizuar një ekspozitë me punimet që i kanë bërë prindërit së bashku me fëmijët në kopsht dhe janë ekspozuar për komunitetin. Ka kopshte që për arsye të pandemisë nuk kanë përfshirë komunitetin në aktivitete.

Disa kopshte kanë organizuar aktivitete në qytet, ku në njërin është punuar nga fëmijët një ekspozitë në shatërvan të qytetit dhe në tjetrin është organizuar një vizitë në një lulishte. Kopshtet tjera nuk kanë realizuar aktivitete jashtë kopshtit për arsye të pandemisë.

Vetëm disa kopshte kanë realizuar aktivitete që kanë marrë pjesë edhe komuniteti, qyteti apo institucionet e organizatat e ndryshme. Një kopsht ka organizuar në oborr të kopshtit festimin e festave me fëmijët e fshatit që nuk janë pjesë e kopshtit. Në kopshtin tjetër kanë realizuar program për fëmijë për RTK2 në gjuhën e tyre dhe dy kopshte tjera kanë mbjellë pemë në rrethojat e kopshtit dhe fëmijët i kanë vendosur emrat e tyre në secilën pemë që kanë mbjellë. Ky aktivitet është realizuar me organizatën Save the Children. Drejtoreshat janë deklaruar se kanë bashkëpunim në nivel drejtoreshash me kopshtet tjera që janë në projektin PEDAPOS, përfshirë edhe drejtoreshat e kopshteve që nuk janë në projekt, por se nuk ka pasur edhe shkëmbim përvojash me edukatore të kopshteve tjera. Janë tri kopshte ku drejtoreshat janë shprehur të mos kenë bashkëpunim në nivel të drejtoreshave dhe as në nivel të edukatoreve.

5. Zhvillimi profesional i edukatoreve

Drejtoreshat dhe edukatorët e të gjitha kopshteve (15 kopshte), kanë deklaruar se projekti PEDAPOS dhe Qasja Reggio Emilia, është një mundësi e mirë dhe kanë qenë me fat që janë kopshte pilot në përfitimin e këtyre të mirave që u ka sjellë projekti. Përparësitë e këtij projekti i ndajnë në dy pika: në atë të furnizimit me materiale, mjete dhe inventar të përshtatshëm për punë me fëmijët dhe në trajnimet që kanë marrë për qasjen e re, ku në veçanti më shumë janë theksuar përvojat e mira për:

Materialet: Prezantim të materialeve, eksplorim, shumëllojshmëri, zgjedhje

nga fëmijët, përdorimi i llojeve të letrës, përfitimet nga trajnimet REMIDA, etj;

Qasjen e edukatores: Fëmijë të lirë dhe të shprehur të lirshëm, gjithçka të fillojë me fëmijën, jo imponim, vetorganizim i fëmijës, hulumtim, vëzhgim, dokumentim, bashkëpunimi me prindërit dhe me stafin tjetër të kopshtit, etj;

Hapësirat: Përdorimi i ateliesë, kuzhina dhe shijet si pjesë e punës edukative, shfrytëzimi i hapësirave të jashtme, etj.

Sfidat dhe mangësitë gjatë trajnimit sipas edukatoreve dhe drejtoreshave janë në:

Ndjekjen e një pjese të trajnimit online: shkëputje të rrjetit, përkthim joprofesional, ndjekja e trajnimit në kohën e punës, pamundësia për t'i parë përvojat nga afër, janë ofruar video por do të ishte më mirë dërgohen që t'i shikojmë kohë pas kohe, etj;

Interpretimin e informatave tek të tjerët: edukatorët nuk janë të sigurt në interpretimin e informatave tek edukatorët tjerë, sidomos në përdorimin e ateliesë, vështirësitë në ndryshimin e qasjes në punën e tyre nga edukatorët e tjerë;

Të tjerë: nuk është dhënë feedback për detyrat e dërguara gjatë trajnimit se a kanë qenë mirë, ku ka mangësi, ngase kështu do të na ndihmonin të përmirësohemi dhe të kuptojmë më mirë këtë qasje, si dhe nuk është kuptuar mirë pjesa e vëzhgimit dhe dokumentimit ku ka nevojë për trajnime shtesë.

Trajnimet që janë zhvilluar në dy vitet e fundit në kopshtet që janë përfshirë në monitorim janë listuar më poshtë. Disa nga kopshtet kanë ndjekur një, dy, tri deri katër trajnime, vetëm një kopsht privat nuk ka ndjekur asnjë trajnim tjetër përveç trajnimeve të projektit PEDAPOS dhe e paraqesin shumë të nevojshme zhvillimin profesional përmes trajnimeve.

Trajnimet që u zhvilluan në kopshte:

- Metodologjia Montesori;
- Disiplina Pozitive (Save the Children);
- Kurrikula për klasën përgatitore (MASHTI);
- Platforma „Edukimi në Distançë - Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0 – 6 vjeç (MASHTI);
- Ushqyeshmëria e shëndetshme- AMC;
- SHPRESE – Përgatitja e Edukatoreve Parafillor për Përkrahjen dhe Zhvillimin e Potencialit të Fëmijëve përmes Lojës dhe Kreativitetit (IPK-CARITAS);
- Ndikimi i stresit pas pandemik Covid/19;
- Ofrimi i ndihmës së parë;
- Gjithpërfshirja;
- Plani individual i Arsimit.

KONKLUZIONE

- Drejtoreshat e edukatoret, në intervistat e realizuara , janë shprehur se trajnimet kanë ofruar përvoja shumë të mira dhe po ashtu, kanë punuar në atë drejtim, që t'i përshtatin hapësirat, inventarin e materialet, bazuar në ato përvoja, për një zhvillim të mirë të fëmijës;
- Planifikimi i punës bëhet bazuar në tema të aktualitetit, stinëve, festave, familjes, profesioneve, duke u fokusuar shumë në arritje të rezultateve të Kurrikules e në Standarde e tregues të zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme. Programi i punës së edukatores, ka filluar të ndryshojë e të planifikohet puna bazuar në interesat e fëmijëve, por vetëm tek disa kopshte dhe jo në të gjitha kopshtet ku pavarësisht ndjekjes së trajnimit, ende janë të përqendruara në programet e parapërgatitura. Ka ende ndonjë rast kur edukatoret nuk janë në gjendje të kthejë interesin e fëmijëve mbi një temë në një mundësi mësimi. Për ta bërë këtë kanë ende nevojë për mbështetje;
- Shfrytëzimi i hapësirave gjatë qëndrimit të fëmijëve në kopsht, në klasat ku realizohet edukimi parashkollor, në pjesën më të madhe të rasteve janë të përshtatshme, kanë kënde të pajisura me materiale, hapësirë të mjaftueshme krahas numrit të fëmijëve, por hapësirat jashtë klasës (korridore, sheshe, etj) nuk shfrytëzohen sa duhet, duke përfshirë edhe ambientin e jashtëm;
- Në shumicën e kopshteve janë funksionalizuar atelietë dhe kanë filluar të shfrytëzohet në mënyra të ndryshme, varësisht nga madhësia, nga numri i fëmijëve, etj. Janë të furnizuara me materiale të llojllojshme. Edukatoret nuk janë të sigurt nëse janë duke e shfrytëzuar si duhet atelienë dhe paraqesin nevojën për trajnime shtesë. Edukatoret kanë marrë përvoja për të prezantuar mirë materialet para fëmijëve dhe që u kanë dhënë mundësinë fëmijëve të hulumtojnë, të prekin, të njihen me detaje të atyre materialeve. Në shumicën e kopshteve ka materiale didaktike të mjaftueshme (letër, ngjyra, ngjitës, lapsa, argjila, etj), ka më pak mjete mjetet didaktike (janë kryesisht vetëm ato që janë sjellë nga projekti PEDAKOS), ka edhe materiale të natyrës dhe materiale të ricikluese;
- Bashkëpunimi në mes të edukatoreve të kopshtit dhe stafit tjetër ka filluar të pësojë ndryshime në proces. Drejtoreshat vëzhgojnë për së afërmi punën e edukatores dhe e mbështesin atë, ka filluar të ketë bashkëpunim me stafin e kuzhinës dhe të bëjnë kuzhinën pjesë të punës edukative, por jo në të gjitha kopshtet, vetëm në disa prej tyre. Po ashtu, edhe bashkëpunimi me profesionist të tjerë, pedagogë, psikologë, edukatorë mbështetës, ndodh në disa raste;
- Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin ka qenë sfidë për të gjitha

kopshtet, për arsye të situatës pandemike. Informimi i prindërve për aktivitetet e realizuara me fëmijë bëhen kryesisht në takimet e shkurtra të vajtje-ardhjes së fëmijëve, por edhe në grupe të mbyllura në facebook dhe viber. Me fillimin e lirit të masave pandemike, ku lejohen deri 30 persona në grupe, kanë filluar edhe aktivitete me prindër dhe komunitete, vizita, pjesëmarrje të prindërve, etj. Edhe bashkëpunimi me komunitetin ishte sfidë në kohë pandemie, në disa raste kur ato aktivitete u realizuan në natyrë, kurse tani kanë filluar të realizohen të njëjtat, me lirin e masave pandemike;

- Format e vëzhgimit që janë realizuar deri më tani nga edukatorët, ndryshojnë nga format e vëzhgimit sipas QRE-së;
- Ka elemente bazë të dokumentimit dhe kjo bëhet përmes fotove, përmes ruajtjes së punimeve të fëmijëve në dosjet e tyre, përmes videove, përmes vendosjes së punimeve në mur të klasës apo tek hyrja e kopshtit ku mund t'i shohin prindërit. Edukatorët kanë paraqitur si një praktikë të mirë mënyrën e dokumentimit sipas QRE-së, por që kanë nevojë të marrin më shumë përvoja që të realizojnë dokumentimin sipas kësaj qasjeje;
- Bazuar në vëzhgimin e bërë në kopshtet pilote është vërejtur që në të gjitha 15 kopshtet përfituese të projektit ka elemente që e dëshmojnë praninë e dokumentimit dhe takimeve në grup të madh të fëmijëve dhe punën në grupe të vogla. Andaj, mund të konkludohet që të gjitha e përdorin qasjen me fëmijën në qendër;
- Ndonjëherë realizojnë ndonjë temë ditore nga interesat e fëmijëve që ndodhin aty për aty. Në grupet ku ka fëmijë me të drejta të veçanta ka nevojë për mbështetje për profesionistë;
- Për zhvillimin profesional të edukatoreve, bazuar në rezultatet e intervistave të realizuara me drejtoresha dhe edukatore, ato kanë treguar përparësitë dhe mundësitë që u ka ofruar projekti PEDAKOS, që përmes pranimit të inventarit, materialeve dhe trajnimeve të nevojshme kanë arritur të marrin hapat e parë të realizimit të Qasjes Reggio Emilia. Kanë veçuar shumë karakteristika të kësaj qasjeje e cila ka qenë risi për ato, siç janë: përdorimi i materialeve, qasja e edukatores, përdorimi i hapësirave;
- Kanë paraqitur edhe vështirësitë gjatë ndjekjes së trajnimit dhe gjatë realizimit në praktikë të përvojave që kanë marrë në trajnim, si: ndjekja e trajnimit online, vështirësitë në interpretimin e informatave tek edukatorët tjerë dhe nevojat për trajnime të tjera për atelie, vëzhgim dhe dokumentim.

REKOMANDIME

- Të theksohet më shumë në procesin edukativ koncepti i 100 gjuhëve të fëmijës;
- Ka nevojë të përmirësohet dokumentimi në aspektin e marrjes dhe ruajtjes së të dhënave, në aspektin e përdorimit për planifikim të punës dhe për mënyrën e duhur të prezantimit para të tjerëve (prindit, komunitetit, etj);
- TEdukatorët janë shprehur se nuk janë shumë të sigurt nëse e kanë kuptuar mirë shfrytëzimin e hapësirave dhe materialeve të ateliesë dhe se kanë nevojë të shohin përvoja lidhur me realizimin e aktiviteteve duke shfrytëzuar si duhet atelienë;
- Të organizohen trajnime shtesë mbi QRE-në (të ofrohen më shumë informata, video, materiale, prezantime, përvoja konkrete, për realizimin në përgjithësi të kësaj qasjeje);
- Krijimi i burimeve për t'i mbështetur edukatorët gjatë implementimit përmes mentorimit dhe mbikëqyrjes së edukatoreve në proces;
- Sigurimi i mundësive për të mbështetur integrimin e fëmijëve me të drejta të veçanta gjatë implementimit të kësaj qasjeje;
- TBazuar në gjetjet e raportit të monitorimit, për secilën mangësi dhe vështirësi të evidentuar në raport të shqyrtohen mundësitë që të ofrohet përkrahje, varësisht ku ka më shumë nevojë, për mbarëvajtjen e realizimit të kësaj qasjeje në kopshtet pilot, që pastaj këto të jenë model për kopshtet tjera në të ardhmen.